**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA**
**KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN**

*Rr. "Adem Jashari" nr.1, Tel.028/571-524, Fax 028/571-232, E-mail: sekretaria_kkvush@Yahoo.com*

Duke u bazuar në nenin 40, paragrafi 40.2 "a" dhe "g" të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 31, paragrafi 31.2 "a" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur më 27.05.2010, mori këtë:

# V E N D I M

## Për ndryshimin e Rregullorës për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale

### Neni 1.

Me këtë Vendim, ndryshohet dhe plotësohet Rregullorja 01 Nr.742/08 e dt.30.12.2008, mbi tarifa, ngarkesat dhe gjobat komunale e aprovuar në Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë.

### Neni 2.

Nenit 27 i shtohet paragrafi 27.4 që ka të bëjë me lëshimin e certifikatave për pëlqim sanitar, caktohet tarifa në mënyrë si vijon:

- Për lokale afariste deri në 30m$^2$................................10.00 €
- Për lokalet afariste deri në 50m$^2$...............................20.00 €
- Për lokalet afariste mbi 100 m$^2$.................................50.00 €
- Për objekt banimi deri 200 m$^2$...................................20.00 €
- Për objekt banimi mbi 200 m$^2$..................................40.00 €

### Neni 3.

Për zbatimin e këtij vendimi është përgjegjëse Drejtoria e Inspekcionit.

### Neni 4.

Ky vendim hynë në fuqi në ditën e aprovimit në mbledhje të Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit
Ferit Idrizi

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**KOMUNA VUSHTRRI**

Në bazë të nenit 14.2 dhe 17 nën "c" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 31.2, "n" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë , Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 27.05.2010, mori këtë:

## V E N D I M
## Për shpalljen e tenderit për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim të pronës së paluajtshme të Komunës

### Neni 1.
Me këtë vendim lejohet shpallja e tenderit për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim të pronës të paluajtshme të Komunës, pjesë e parcelës kadastrale P-70202028-00412-0 në sipërfaqe prej 02.00.00 ha, ZK-le Stanoc i Poshtëm, e evidentuar në Certifikatën e pronësisë UL-70202028-00198, pronë e Komunës së Vushtrrisë.

### Neni 2.
Palujtshmëria e cekur si në nenin 1 të këtij vendimi ipet në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim për zhvillimin e veprimtarive të ndryshme shërbyese, prodhuese, tregtare etj.

### Neni 3.
Të drejtat dhe detyrimet që pasojnë nga ky vendim për shfrytëzim të përkohshëm të palujtshmërisë me kompensim do të rregullohen me akt të veçantë, konform dispozitave ligjore në fuqi.

### Neni 4.
Obligohet Drejtoria e Prokurimit që të shpall tender për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të patundshmërisë në fjalë konform dispozitave ligjore në fuqi.

### Neni 5
Obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit dhe Drejtoria për Inspeksion të zbatojnë Ligjin e ndërtimit dhe standardet e kontrollit të ndërtimit si dhe mbrojtjen e mjedisit.

### Neni 6
Ky Vendim hynë në fuqi në ditën e aprovimit në mbledhje të Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit
Ferit Idrizi

**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA**
**KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN**

Bazuar në nenin 40.2, "c" të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe 31.2, "c" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 27.05.2010, mori këtë:

# V E N D I M

## Neni 1.

Me këtë vendim lejohet ridestinimi i mjeteve të lira buxhetore në shumë prej 68.014.00 €, mjete shtesë për rritje të vlerës së projektit: "Asfaltimi i rrugës në fsh. Stanoc i Epër, Lagja "Hoxhaj", "Kosumi", "Haradinaj", "Prronaj".

## Neni 2.

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Prokurim Publik në Vushtrri.

## Neni 3.

Ky vendin hyn në fuqi në ditën e miratimit në mbledhje të Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit
Ferit Idrizi

Bazuar në nenin 40.2, "c" të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe 31.2, "c" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 27.05.2010, mori këtë:

# V E N D I M

## Neni 1.

Me këtë vendim lejohet ridestinimi i mjeteve të lira buxhetore të mbetura nga kodi ekonomik 81145 në shumë prej 7.000 €, të cilat do të shfrytëzohen për blerjen e aparatit fotokopjues për nevoja të Sekretarisë së Komunës.

## Neni 2.

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Prokurim Publik në Vushtrri.

## Neni 3.

Ky vendin hyn në fuqi në ditën e miratimit në mbledhje të Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit

Ferit Idrizi

**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA**
**KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN**

Bazuar në nenin 40.2, "e" dhe 40.3 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 si dhe 31.2, "o" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 27.05.2010, mori këtë:

V E N D I M

Neni 1.
Me këtë vendim formohet komisioni për shqyrtim të propozimeve për ndarje të Plaketave dhe Mirënjohjeve për nder të ditës së çlirimit të Vushtrrisë.

Neni 2.
Në përbërje të komisionit caktohen këta anëtar të Kuvendit:

- Gani Imeri
- Melihate Basholli
- Habib Mustafa
- Sabri Ferati
- Remzije Isufi

Neni 3.
Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të shqyrtoj propozimet për Plaketat dhe Mirënjohjet të cilat do të ndahen–dorëzohen më 17 qershor 2010, në solemnitetin e organizuar me rastin e ditës së Çlirimit të Vushtrrisë.
Propozimet me shkrim duhet të i dorëzohen Komitetit për Politikë dhe Financa më së largu deri më 04.06.2010 për të marr Vendim lidhur me të njëjtat.

Neni 4.
Ky vendin hyn në fuqi në ditën e miratimit në mbledhje të Kuvendit.

Neni 5.
Me këtë Vendim njoftohen secili nga anëtarët e komisionit.

Kryesuesi i Kuvendit
Ferit Idrizi

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**KUVENDI I KOMUNËS VUSHTRRI**

Në bazë të nenit 14.2 dhe 17, "c" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 31.2, "n" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 27.05.2010, mori këtë:

# V E N D I M

Për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim të pronës së paluajtshme të komuinës

**Neni 1.**

1.1 Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës-PTK Sh.A nga Prishtina i lejohet për shfrytëzim prona e paluajtshme e komunës, në sipërfaqe prej 0.01.00ha (100m2), e cila është pjesë e parcelës kadastrale nr.302-2, Komuna Kadastrale Qytezë (Smrekonicë), evidentuar në fletën poseduese nr.87, pronë e Komunës së Vushtrrisë.

**Neni 2.**

2.1 Patundshmëria e cekur si ne nenin 1 të këtij vendimi i ipet në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim për vendosjen e objektit të tipit montazh (të ashtuquajtura "Butik Posta") në afat prej 1 viti me mundësi vazhdimi.
2.2 Kompensimi për shfrytëzimin e pronës së paluejtshme në pronësi të Komunës të cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të bëhet konform Rregullores komunale për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale 01Nr.742/08, dt. 30.12.2008 (neni 17).

**Neni 3.**

3.1 Të drejtat dhe detyrimet që pasojnë nga ky vendim për shfrytëzim të përkohshëm të palujtshmërisë do të rregullohen konform dispozitave në fuqi me kontratë të cilën pala është e obliguar ta lidh në organin kompetent. Komuna ka të drejtën e shkëputjes së kontratës për shfrytëzim para kalimit të këtij afati nëse për ketë ekziston interesi i Komunës.

**Neni 4**

4.1 Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit.

**Neni 5**

5.1 Ky Vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë.

**Kryesuesi i Kuvendit**
**Ferit Idrizi**

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**KUVENDI I KOMUNËS VUSHTRRI**

Në bazë të nenit 14.2 dhe 17 "c" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 31.2, "n" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë , Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 27.05.2010, mori këtë:

**V E N D I M**

Për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim të pronës së paluajtshme të Komunës

**Neni 1.**

1.1 Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës-PTK Sh.A nga Prishtina i lejohet për shfrytëzim të përkohshëm prona e paluajtshme e komunës, në sipërfaqe prej 0.01.00ha ($100m^2$), e cila është pjesë e parcelës kadastrale nr.434-1 Komuna Kadastrale Lummadh, evidentuar në fletën poseduese nr.70, pronë e Komunës së Vushtrrisë.

**Neni 2.**

2.1 Patundshmëria e cekur si ne nenin 1 të këtij vendimi i ipet në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim për vendosjen e objektit të tipit montazh (të ashtuquajtura "Butik Posta") në afat prej 1 viti me mundësi vazhdimi.

2.2 Kompensimi për shfrytëzimin e pronës të cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të bëhet konform Rregullores komunale për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale 01Nr.742/08, dt. 30.12.2008 (neni 17).

**Neni 3.**

3.1 Të drejtat dhe detyrimet që pasojnë nga ky vendim për shfrytëzim të përkohshëm të palujtshmërisë do të rregullohen konform dispozitave në fuqi me kontratë të cilën pala është e obliguar ta lidh në organin kompetent. Komuna ka të drejtën e shkëputjes së kontratës për shfrytëzim para kalimit të këtij afati nëse për ketë ekziston interesi i Komunës.

**Neni 4**

4.1 Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit.

**Neni 5**

5.1 Ky Vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit në mbledhje të kuvendit.

**Kryesuesi i Kuvendit**
**Ferit Idrizi**

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**KUVENDI I KOMUNËS VUSHTRRI**

Në bazë të nenit 14.2 dhe 17 "c" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 31.2, "n" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës në seancën e mbajtur më 27.05.2010, mori këtë:

# V E N D I M

Për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim të pronës së paluajtshme të Komunës

## Neni 1.

1.1 Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës-PTK Sh.A nga Prishtina i lejohet për shfrytëzim të përkohshëm prona e paluajtshme e komunës, në sipërfaqe prej 0.01.00ha (100$m^2$), e cila është pjesë e parcelës kadastrale nr.603-2 Komuna Kadastrale Pestovë, evidentuar në fletën poseduese nr.232, pronë e Komunës së Vushtrrisë.

## Neni 2.

2.1 Patundshmëria e cekur si ne nenin 1 të këtij vendimi i ipet në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim për vendosjen e objektit të tipit montazh (të ashtuquajtura "Butik Posta") në afat prej 1 viti me mundësi vazhdimi.

2.2 Kompensimi për shfrytëzimin e pronës së paluejtshme në pronësi të Komunës të cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të bëhet konform Rregullores komunale për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale 01Nr.742/08, dt. 30.12.2008 përkatësisht neni 17 të kësaj rregulloreje.

## Neni 3.

3.1 Të drejtat dhe detyrimet që pasojnë nga ky vendim për shfrytëzim të përkohshëm të palujtshmërisë do të rregullohen konform dispozitave në fuqi me kontratë të cilën pala është e obliguar ta lidh në organin kompetent. Komuna ka të drejtën e shkëputjes së kontratës për shfrytëzim para kalimit të këtij afati nëse për ketë ekziston interesi i Komunës.

## Neni 4

4.1 Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit.

## Neni 5

5.1 Ky Vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit në mbledhje të Kuvendit.

**Kryesuesi i Kuvendit**
**Ferit Idrizi**